



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.864/ 7 prot.

Datë 31.03.2026

V E N D I M
Nr. 446/2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 31.03.2026 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “*REJ*” SHPK në procedurën e prokurimit “*E hapur, e thjeshtuar*”, me Nr. *REF-75943-02-12-2026*, me objekt: “*Sherbime te pastrimit*”, me fond limit 9,776,333.00, zhvilluar me datë 24.02.2026, nga autoriteti kontraktor, Tirana Parking

Skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “*Silver*” SHPK, në procedurën e mësipërme të prokurimit

Lënien të skualifikuar dhe shtimin e arsyeve të skualifikimit të ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “*Pastrime Silvio*” SHPK, në procedurën e mësipërme të prokurimit

Lënien të skualifikuar dhe shtimin e arsyeve të skualifikimit të ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “*Clean Fast*” SHPK, në procedurën e mësipërme të prokurimit.

- Ankimues:** Operatori ekonomik “*REJ*” SHPK me NIPT: J93711608Q, dhe me adresë: *Rruga “Dritan Hoxha”, Ngjitur me Shkollën “Ahmet Gashi”, Kulla Jeshile, Nr.Pasuri 8/374 /ND+3-6, H, Tiranë.*
- Autoriteti Kontraktor:** Tirana Parking me adresë: *Rruga Ali Begeja, Kodi postar 1017, Tirane*
- Subjekte të interesuar:** Operatori ekonomik “*Silver*” SHPK me NIPT K88010301S dhe adresë: *Tirane , Njesia Bashkiake Nr 5,Rruga Bajram Curri, Nr.Pasurie 5/247+1N4,Zona Kadastrale 8260,Pallati Palma e Arte*
- Operatori ekonomik “*Clean Fast*” SHPK me NIPT: L61807037R, dhe me adresë: *Bulevardi “Bajram Curri”, Godina ETC, Kati 13, Tiranë.*
- Operatori ekonomik “*Pastrime Silvio*” SHPK me NIPT: K91413010N, dhe me adresë: *Njësia Bashkiake nr. 2, Rruga “Fatmir Haxhiu”, Pallati 2, Shkalla 10, Apartamenti 76, Kati I Tiranë.*
- Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.*

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I 1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e lartë monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 13.02.2026, është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-75943-02-12-2026, me objekt: “*Sherbime te pastrimit*”, me fond limit 9,776,333.00, zhvilluar me datë 24.02.2026, nga autoriteti kontraktor, Tirana Parking.

II.2. Në datë 24.02.2026, autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.3. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe informacionit të operatorit ekonomik ankimues rezulton, se në datën 02.03.2026, është bërë klasifikimi i operatorëve ekonomikë pjesëmarrës, duke i njoftuar me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të ofertave ekonomike për vlerat (pa TVSH) si më poshtë:

1. “Clean Fast” SHPK	8,986,463 lekë	skualifikuar
2. “S i l v e r” SHPK	9,254,000 lekë	kualifikuar
3. “Pastrime Silvio” SHPK	9,288,323 lekë	skualifikuar
4. “Rej” SHPK	9,351,914.6 lekë	skualifikuar

II.4. Operatori ekonomik “REJ” SHPK shpk rezulton i skualifikuar për arsye se:

“1. Operatori ekonomik nuk plotëson kërkesat e veçanta për kualifikim sipas pikës 2.3.2, Seksioni 2.3 Kapaciteti teknik:Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar në SPE nga Operatori Ekonomik “REJ” sh.p.k., rezultoi se, për përmbushjen e këtij kriteri ka paraqitur: - Formularin përmbledhës të vetëdeklarimit (Shtojca 10), Pjesa II; Seksioni B ”Deklarate”. - Licencën III.2.B. referuar pikës 2.3.6 të seksionit 2.3 Kapaciteti teknik. Nga verifikimi në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit OE “REJ” sh.p.k., ka deklaruar si Inxhinierë Mjedisi Z. B.G., ndërsa në Licencën III.2.B. ka të deklaruar si drejtues teknik Znj. D.M. Për plotësimin e Formularëve Përmbledhës të Vetëdeklarimit është shprehur edhe Komisioni i Prokurimit Publik me Vendimin Nr.1237/2023, datë 30.11.2023, në të cilin është përcaktuar qartësisht “Komisioni sjell në vëmendje të operatorëve ekonomik pjesmarrës në një procedurë prokurimi, se në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, duhet të plotësojnë cdo rubrikë të kërkuar nga autoriteti kontraktor sipas kriterëve të përcaktuara në dokumentat standarte të tenderit, pasi vendosja e këtyre kriterëve i shërben autoritetit kontraktor të njohë gjendjen dhe kapacitetet e operatorëve të cilët duhet të vërtetojnë se i plotësojnë kërkesat e autoritetit kontraktor. Në rastin konkret, procedura e prokurimit ndodhej në fazën ku operatorët ekonomik për plotësimin e kriterëve të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, i përmbush nëpërmjet plotësimin dhe dorëzimit të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, ndaj plotësimi i këtij formulari jo në përputhje me kriteret e hartuara nga autoriteti kontraktor, përbën shkak për skualifikim”. Përsa më sipër OE “REJ” sh.p.k., nuk e përmbush pikën 2.3.2 të seksionit 2.3 Kapaciteti teknik, pasi nuk përputhet Drejtuesi Teknik i deklaruar në Shtojcën 10 dhe në licencën e shoqërisë për kategorinë III.2.B, duke përmbushur kushtin për skualifikim.

2. Operatori ekonomik nuk plotëson kërkesat e veçanta për kualifikim sipas pikës 2.2.4., Seksioni 2.4 Kapaciteti financiar: Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar në SPE nga Operatori Ekonomik “REJ” sh.p.k., rezultoi se, për përmbushjen e këtij kriteri ka paraqitur: - Formularin përmbledhës të vetëdeklarimit (Shtojca 10). Nga verifikimi në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit dhe Ekstraktin historik të OE “REJ” sh.p.k, rezulton se selia qendrore e kompanisë, krahas vendeve të tjera të ushtrimit të aktivitetit është adresa: “Tiranë, Zogu i Zi, Qatar Center”, pra e ushtron aktivitetin brenda territorit të Bashkisë Tiranë, dhe si rrjedhim në Shtojcën 10 duhet të ishte vetëdeklaruar nga ana e OE, pagesa e të gjitha detyrimeve që rrjedhin nga kontratat e furnizimit me ujë. KVO sqaron se është detyrim ligjor i subjektit ofertues të provojë me dokumentacion të plotë dhe në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor plotësimin e kriterëve të kërkuara në dokumentet e tenderit, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme, dhe në fazën e ofertimit në SPE, AK mbështetet në shqyrtimin e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, në të cilin nuk është përmbushur pika 2.2.4.”

II.5. Referuar sistemit të prokurimit elektronik rezulton se me 09.03.2026 është publikuar njoftimi i fituesit paraprak të procedurës së mësipërme të prokurimit.

II.6. Në datën 17.03.2026 nëpërmjet sistemit të ankesave elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, është protokolluar ankesa me nr. 864/2026, datë

17.03.2026 dhe numër ankimi elektronik A/2026/6437, datë 18.03.2026, e operatorit ekonomik “Rej” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-75943-02-12-2026, me objekt: “Sherbime te pastrimit”, me fond limit 9,776,333.00, zhvilluar me datë 24.02.2026, nga autoriteti kontraktor, Tirana Parking.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, konstatohet se objekti i ankesës lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Rej” SHPK.

Gjithashtu operatori ekonomik “Rej” SHPK, kërkon skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Silver” SHPK, si dhe lënien të skualifikuar dhe shtimin e arsyeve të skualifikimit të ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Clean Fast” SHPK dhe nga operatori ekonomik “Pastrime Silvio” SHPK, në këtë procedurë prokurimi.

II.7. Në përputhje me nenin 112 “*Veprimet paraprake*” të Ligjit nr.162/2020 “*Për Prokurimin Publik*” i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. 864/1 prot., datë 18.03.2026.

II.8. Me shkresën e protokolluar me tonën me nr. 864/2 prot., datë 19.03.2026 operatori ekonomik “Silver” SHPK ka paraqitur në sistemin e ankesave elektronike dokumenta provues bazuar në pretendimet që operetori ekonomik ankimues ka paraqitur në ankesë mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Silver” SHPK, në procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.9. Me datë 20.03.2026 protokolluar me tonën me nr. 864/3 prot., datë 24.03.2026 operatorit ekonomik “Silver” SHPK në cilësinë e subjektit të interesuar në kuptim të nenit 113 të LPP-së ka paraqitur në sistemin e ankesave elektronike formularin e argumentave.

II.10. Nëpërmjet shkresës me nr.217/12 prot., datë 26.03.2026 protokolluar me tonën me nr.864/4 prot., datë 27.03.2026, autoriteti kontraktor ka depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik vendimin nr. 217/11 prot., datë 26.03.2026 të KSHA lidhur me trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues, nga ku rezulton, se ka vendosur mospranimin e ankesës duke argumentuar:

Pala ankimuese "REJ" shpk pretendon si më poshtë vijon:

1. Lidhur me pretendimin e mëposhtëm:

"Lidhur me arsyen e parë të skualifikimit të operatorit Rej shpk me argumentin se: Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar në SPE nga Operatori Ekonomik "REJ" sh.p.k., rezultoi se, për përmbushjen e këtij kriteri ka paraqitur: - Formularin përmbledhës të vetëdeklarimit (Shtojca 10), Pjesa II; Seksioni B "Deklaratë". - Licencën III.2.B. referuar pikës 2.3.6 të seksionit 2.3 Kapaciteti teknik. Nga verifikimi në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit OE "REJ" sh.p.k., ka deklaruar si Inxhinier Mjedisi Z. B.G., ndërsa në Licencën III.2.B. ka të deklaruar si drejtues teknik Znj. D.M. Për plotësimin e Formularëve Përmbledhës të Vetëdeklarimit është shprehur edhe Komisioni i Prokurimit Publik me Vendimin Nr.1237/2023, datë 30.11.2023, në të cilin është përcaktuar qartësisht "Komisioni sjell në vëmendje të operatorëve ekonomik pjesmarrës në një procedurë prokurimi, se në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, duhet të plotësojnë cdo rubrikë të kërkuar nga autoriteti kontraktor sipas kriterëve të përcaktuara në dokumentat standarte të tenderit, pasi vendosja e këtyre kriterëve i shërben autoritetit kontraktor të njohë gjendjen dhe kapacitetet e operatorëve të cilët duhet të vërtetojnë se i plotësojnë kërkesat e autoritetit kontraktor. Në rastin konkret, procedura e prokurimit ndodhej në fazën ku operatorët ekonomik për plotësimin e kriterëve të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, i përmbush nëpërmjet plotësimit dhe dorëzimit të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, ndaj plotësimi i këtij formulari jo në përputhje me kriteret e hartuara nga autoriteti kontraktor, përbën shkak për skualifikim". Në pikën 2.3.2 dhe 2.3.6 të Dokumentave të Tenderit është përcaktuar:

2.3.2 Operatori Ekonomik duhet të vërtetojë se disponon një Drejtues teknik si Inxhinier Mjedisi të cilin duhet ta ketë në Licensë me kualifikimet e duhura për kryerjen e të gjitha shërbimeve në këtë objekt. Për këtë operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacion se ka të punësuar tij: - 1 (një) Inxhinier Mjedisi. Për të vërtetuar plotësimin e këtij kriteri, Operatorët Ekonomikë duhet të paraqesin diplomë, kontratat e punës (të vlefshme brenda afatit të vlefshmërisë së ofertës), CV përkatëse. Shënim: Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit sipas Shtojcës 10. Operatori ekonomik i kualifikuar i pari në klasifikim duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit. Autoriteti Kontraktor rezervon të drejten të kryejë të gjithë verifikimet e nevojshme për të vërtetuar deklarimin e mësipërm. 2.3.6 Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me leje të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licencimit (QKL) për ushtrim e aktivitetit objekt i prokurimit (e vlefshme): a.Licence e lëshuar nga QKL për grumbullim dhe transportim të mbetjeve urbane dhe transportim i mbetjeve jo të rrezikshme,mbetje inerte dhe mbetjeve të llumrave nga gropat septike dhe nga pastrimi i ujerave të zeza të lëshuar nga QKL Kodi III.2.B. b. Licencë të lëshuar nga QKL me kod II.8.A c. Licencë të lëshuar nga QKL DDD me kod II.8.B.

Për plotësimin e kriterit të pikës 2.3.2 të kapacitetit teknik kemi dorëzuar në SPE Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit sipas Shtojcës 10, në të cilin kemi deklaruar se drejtues teknik me diplomë të Inxhinierit të Mjedisit është z. B.G. Pra kriteri i përcaktuar në pikën 2.3.2 të Kapacitetit teknik të DT-ve është përmbushur nga ana jonë pasi për këtë fazë kërkohet që ky kriter plotësohet vetëm me dorëzimin e FPV.

Sa i përket pretendimit të komisionit të vlerësimit të ofertave, se "Nga verifikimi në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit OE "REJ" sh.p.k., ka deklaruar si Inxhinier Mjedisit Z. B.G., ndërsa në Licencën III.2.B. ka të deklaruar si drejtues teknik Znj. D.M", sqarojmë se për t'u pajisur me licencën e kategorisë III.2.B, për të cilën pasi dorëzohet dokumentacioni i kërkuar si dhe detyrimi për të patur kontratë pune me një inxhinier mjedisit, lëshohet licenca e cila është paafat. Për shkak apo arsye objektive, operatori mbajtës i licencës mund të ndryshojë drejtuesin teknik të deklaruar fillimisht, por pavarësisht kësaj licenca mbetet ajo e lëshuar fillimisht pa patur detyrimin për ndryshimin e saj. Por përtej kësaj, mbështetur në dispozitat mësipërme, autoriteti kontraktor nuk është në kushtet për të bërë një vlerësim i cili nuk i përket kësaj faze, pasi operatori ynë nuk ka dorëzuar dokumentacion fizik në përputhje me parashikimet e nenit 82 të LPP dhe nenit 26 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021.

Në vijim, KSHA pasi shqyrtoi parashtrimet dhe pretendimet e operatorit ekonomik ankimues, dokumentacionin që administrohet në dosjen e procedurës së prokurimit dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi, gjykon se:

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar, KSHA konstaton se në shtojcën 9, paragrafi 2 "Kriteret e veçanta të kualifikimit", pika 2.3.2 "Kapaciteti teknik", përcaktohet kriteri i vendosur nga Autoriteti Kontraktor si më poshtë:

"Operatori Ekonomik duhet të vërtetojë se disponon një Drejtues teknik si Inxhinier Mjedisit të cilin duhet ta ketë në Liçensë me kualifikimet e duhura për kryerjen e të gjitha shërbimeve në këtë objekt. Për këtë operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacion se ka të punësuar tij:

- 1 (një) Inxhinier Mjedisit.

Për të vërtetuar plotësimin e këtij kriteri, Operatorët Ekonomikë duhet të paraqesin diplomë, kontratat e punës (të vlefshme brenda afatit të vlefshmërisë së ofertës), CV përkatëse".

Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar, rezulton se operatori ekonomik "REJ" shpk në përmbushje të kriterit sa më sipër ka dorëzuar dokumentacionin "_10_Shtojca10_Vetëdeklarimi", në të cilën ka deklaruar në Deklaratën B: "Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen)" ka deklaruar konkretisht:

"Profili i punonjësve

1. Z.Bledar Guri me profesion Inxhinier Mjedisit i punësuar pranë kompanisë tone në rolin e Drejtues Teknik Inxhinier Mjedisit"

Ndërkohë, referuar dokumentacionit të dorëzuar në SPE nga OE ankimues, rezulton se sipas Liçencës III.2.B., OE ka të deklaruar si drejtues teknik Znj. D.M.

Në nenin 77 pika 1, të ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", parashikohet shprehimisht se:

"Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*

c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës."

Në nenin 77, pika 4 e ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik" (i ndryshuar), parashikohet:

"Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie".

Në nenin 26, pika 1 e VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" (i ndryshuar), parashikohet se:

"Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla."

Në nenin 26, pika 2 e VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" (i ndryshuar), parashikohet se:

"2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarin, si më poshtë vijon: ...h)operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti); ..."

Operatori ekonomik ankimes pretendon se:

"Licenca është pa afat dhe nuk është e detyrueshme të përditësohet në rast ndryshimi të drejtuesit Teknik dhe në këtë fazë mjafton deklarimi në FPV dhe autoriteti kontraktor nuk duhet të kryejë verifikime të mëtejshme"

KSHA gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushjen me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

Mbështetur në legjislacionin sa më sipër, KSHA nga verifikimi i kriterëve të përcaktuara nga AK, vëren se, në DST është përcaktuar shprehimisht se, operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar një inxhinier mjedisi, i cili të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë. Ky kriter është i qartë dhe kërkon një përputhje të drejtpërdrejtë midis personit të deklaruar si inxhinier mjedisi, dhe personit të reflektuar në licencën përkatëse.

Nga dokumentacioni i paraqitur nga vetë operatori ekonomik evidentohet një mospërputhje faktike, pasi në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit deklarohet një person, ndërsa në licencë figuron një person tjetër. Kjo mospërputhje përbën mosplotësim të kriterit të kërkuar nga autoriteti kontraktor. Pretendimi i operatorit ekonomik se licenca është pa afat dhe nuk kërkon përditësim nuk qëndron në raport me kërkesën e DST, pasi autoriteti kontraktor vlerëson përmbushjen e kriterëve

në momentin e ofertimit dhe operatori ekonomik duhet të provojë se plotëson kushtet e vendosura në DST në këtë moment. Fakti që licenca mund të mos jetë përditësuar, nuk e përjashton operatorin nga detyrimi për të përmbushur kriterin e vendosur. Në këto kushte, autoriteti kontraktor ka të drejtë dhe detyrim të konstatojë këtë mospërputhje dhe të vlerësojë kriterin si të papërmbushur.

Referuar pikës 2, të nenit 82 të VKM Nr.285/2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" (i ndryshuar), përcakohet se: "Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme".

Për sa më sipër, KSHA gjykon se pretendimi i Operatorit ekonomik "REJ" sh.p.k nuk qëndron.

2. Lidhur me pretendimin e mëposhtëm:

"Lidhur me arsyen e dytë të skualifikimit të operatorit "Rej" shpk me argumentin se: Operatori ekonomik nuk plotëson kërkesat e vecanta për kualifikim sipas pikës 2.2.4., Seksioni 2.2 Kapaciteti financiar: Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar në SPE nga Operatori Ekonomik "REJ" sh.p.k., rezultoi se, për përmbushjen e këtij kriteri ka paraqitur: - Formularin përmbledhës të vetëdeklarimit (Shtojca 10). Nga verifikimi në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit dhe Ekstraktin historik të OE "REJ" sh.p.k, rezultoi se selia qendrore e kompanisë, krahas vendeve të tjera të ushtrimit të aktivitetit është adresa: "Tiranë, Zogu i Zi, Qatar Center", pra e ushtron aktivitetin brenda territorit të Bashkisë Tiranë, dhe si rrjedhim në Shtojcën 10 duhet të ishte vetëdeklaruar nga ana e OE, pagesa e të gjitha detyrimeve që rrjedhin nga kontratat e furnizimit me ujë. KVO sqaron se është detyrim ligjor i subjektit ofertues të provojë me dokumentacion të plotë dhe në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor plotësimin e kriterëve të kërkuara në dokumentet e tenderit, pasi ofertat që nuk përparojnë në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme, dhe në fazën e ofertimit në SPE, AK mbështetet në shqyrtimin e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, në të cilin nuk është përmbushur pika 2.2.4.

Për plotësimin e këtij kriteri ne kemi dorëzuar Formualin Përmbledhës së Vetëdeklarimit ashtu sikurse e kërkon vetë autoriteti kontraktor. Së pari, në Formularin Përmbledhës së Vetëdeklarimit nuk ka një format ose pyetësor standart për këtë kriter që të plotësohet nga ana jonë ?!

Së dyti, Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit, është një formular standart i hartuar nga Agjencia e Prokurimit Publik dhe plotësohet apo jepen të dhëna për deklarime aq dhe sic është përcaktuar në këtë formular. As autoriteti kontraktor dhe as operatorët ekonomikë nuk mund të ndërhyjnë në këtë formular, ai plotësohet ashtu sikurse është pjesë e dokumentave të tenderit. Së treti, kriteri për paraqitjen një vërtetimi që operatori ka paguar faturat e ujit, nuk gjen asnjë mbështetje ligjore e as nënligjore. Kjo është një kontratë shërbimi dhe mbështetur në nenin 77 të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 dhe nenit 41 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, nuk parashikohet përcaktimi i një kriteri të tillë. Për sa më sipër kriteri i për të cilin autoriteti pretendon se nuk përmbushet nga ana jonë është plotësisht i përmbushur me dokumentacionin e dorëzuar në SPE".

Në vijim, KSHA pasi shqyrtoi parashtrimet dhe pretendimet e operatorit ekonomik ankimues, dokumentacionin që administrohet në dosjen e procedurës së prokurimit dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi, gjykon se:

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar, KSHA konstaton se në shtojcën 9, paragrafi 2 "Kriteret e veçanta të kualifikimit", pika 2.2.4 "Kapaciteti ekonomik dhe financiar", përcaktohet kriteri i vendosur nga Autoriteti Kontraktor si më poshtë:

"Vërtetimi i lëshuar nga shoqëria "Ujësjetllës Kanalizime Tiranë" sha, i cili konfirmon pagesën e të gjitha detyrimeve që rrjedhin nga kontratat e furnizimit me ujë. (Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit).

Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr. 10 të Dokumentave Standarte të Tenderit, Autoriteti/enti Kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese".

Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar, rezulton se operatori ekonomik "REJ" shpk në përmbushje të kriterit sa më sipër ka dorëzuar dokumentacionin "_10_Shtojca10_Vetëdeklarimi". Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur në SPE rezultoi se operatori ekonomik ka paraqitur Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe në asnjë pjesë të këtij formulari nuk është vetëdeklaruar shlyerja e detyrimeve ndaj shoqërisë Ujësjetllës Kanalizime Tiranë, ndaj për rrjedhojë, kriteri i përcaktuar në pikën 2.2.4 nuk rezulton i përmbushur.

Autoriteti Kontraktor ka parashikuar në mënyrë të qartë dhe të shprehur detyrimin për të provuar shlyerjen e detyrimeve ndaj UKT, për të siguruar Autoritetin Kontraktor që për dhënien e kontratës të kontraktohen operatorë ekonomikë të cilët nuk kanë detyrime të pashlyera të furnizimit me ujë sipas objektit ku ushtrojnë aktivitetin, në Bashkinë e Tiranës. Vendosija e këtij kriteri siguron institucionin se edhe në rast detyrimesh të pashlyera, operatorët ekonomik kanë periudhën e nevojshme kohore për të shlyer këto detyrime përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit. Githashtu në DST është përcaktuar qartë edhe mënyra e përmbushjes së këtij kriteri në fazën e ofertimit, përmes Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit (Shtojca 10).

KSHA vlerëson se kërkesa për vetëdeklarim nuk është një formalitet, por një kusht thelbësor kualifikues dhe mosdeklarimi i një elementi të kërkuar nuk mund të konsiderohet si pasaktësi formale, por si mungesë e provimit të përmbushjes së kriterit në fazën e ofertimit.

Në zbatim të dokumenteve të tenderit dhe legjislacionit për prokurimin publik, Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit përbën bazën e vetme të verifikimit në fazën e ofertimit në SPE dhe operatorët ekonomikë kanë detyrimin të deklarojnë në mënyrë të plotë, të saktë dhe të qartë përmbushjen e çdo kriteri kualifikues. Mosdeklarimi i një elementi të kërkuar në këtë formular përbën mosplotësim të kriterit të kërkuar.

Për pasojë, KSHA gjykon, se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi duhet të plotësojnë vetëm kërkesat e vendosura në dokumentet e tenderit, e rrjedhimisht, vlerësimi e kualifikimi i tyre duhet të bëhet në përputhje vetëm me këto kërkesa. Pra, kriteret e përgjithshme dhe të veçanta kur është e përcaktuar duhet të përmbushen, nëpërmjet paraqitjes së Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit nga operatori ekonomik, sipas shtojcës 10 të DST.

Për sa më sipër, KSHA gjykon se pretendimi i Operatorit ekonomik "REJ"sh.p.k nuk qëndron.

3. Lidhur me pretendimin e mëposhtëm:

"Lidhur me kundërshtimin e kualifikimit të subjektit Silver shpk:

Së pari, Operatori Silver shpk është kualifikuar në vendin e parë të kësaj procedure prokurimi dhe pas kërkesës së bërë prej autoritetit kontraktor, me qëllim dorëzimin e dokumentacionit origjinal ose të noterizuar, sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 26 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "RPP

të ndryshuar, nuk ka dorëzuar të gjithë dokumentacionin provues për secilën prej rubrikave të vetëdeklaruarara në Formularin Përmbledhës së Vetdeklarimit. Nisur nga procedurat e mëparëshme, kemi vërejtur se ky operator është skualifikuar për mosdorëzimin e dokumentave të vetdeklaruarara prej tij në formularin përmbledhës së vetdeklarimit, Shtojca 9.

-Konkretisht, OE Silver shpk ka dorëzuar dokumentacion provues që operatori i tij ekonomik nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale. (Vertetim i Gjendjes Gjyqësore të Subjektit i lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve), por vërtetimi i paraqitur është lëshuar me një datë më të vonshme se data e hapjes së ofertave. Sipas nenit 26 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, kërkohet që dokumentat e tenderit duhet të përmbajnë gjendjen faktike të datës së hapjes së ofertave”.

Në vijim, KSHA pasi shqyrtoi parashtrimet dhe pretendimet e operatorit ekonomik ankimues, dokumentacionin që administrohet në dosjen e procedurës së prokurimit dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi, gjykon se:

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar, KSHA konstaton se referuar Shtojcës 9, është përcaktuar se: *“Ofertuesi deklaron se: d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;”*.

Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar pranë Autoritetit Kontraktor rezulton se, operatori ekonomik “S I L V E R” shpk, në përmbushje të kriterëve të përgjithshme të përcaktuara në Dokumentat Standarte të Tenderit ka dorëzuar Vërtetimin Nr.II prot., datë 07.02.2026, nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, sipas të cilit rezulton se, subjekti “S I L V E R” shpk rezulton i padënuar në Regjistrin e Gjendjes Gjyqësore. Gjithashtu, provohet se vërtetimi është lëshuar përpara hapjes së ofertave nga ana e Autoritetit Kontraktor.

Referuar pikës 2 të nenit 82 të VKM-së Nr.285.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), përcaktohet se:

“Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme”.

KSHA gjykon se, operatori ekonomik i kualifikuar “S I L V E R” shpk plotëson me anë të dokumentacionit provues pranë AK, kriterin e përgjithshëm të sipërcituar në DST.

Për sa më sipër, KSHA gjykon se pretendimi i Operatorit ekonomik “REJ”sh.p.k nuk qëndron.

4. Lidhur me pretendimin e mëposhtëm:

“- OE Silver shpk nuk ka dorëzuar dokumentacion provues që operatori i tij ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi. Gjithashtu vërtetimi i paraqitur është lëshuar me një datë më të vonshme se data e hapjes së ofertave. Sipas nenit 26 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, kërkohet që dokumentat e tenderit duhet të përmbajnë gjendjen faktike të datës së hapjes së ofertave”.

Në vijim, KSHA pasi shqyrtoi parashtrimet dhe pretendimet e operatorit ekonomik ankimues, dokumentacionin që administrohet në dosjen e procedurës së prokurimit dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi, gjykon se:

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar, KSHA konstaton se referuar Shtojcës 9, është përcaktuar se: *"Ofertuesi deklaron se: e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë"*.

Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar pranë Autoritetit Kontraktor rezulton se, operatori ekonomik "S I L V E R" shpk, në përmbushje të kriterëve të përgjithshme të përcaktuara në Dokumentat Standarte të Tenderit ka dorëzuar Vërtetimin OSHEE-2026-1870552-HS prot., datë 09.02.2026, nga Furnizuesi i Shërbimit Universal (FSHU), sipas të cilit rezulton se, subjekti "S I L V E R" shpk nga verifikimet e kryera në Sistemin e Faturimit për kontrata, përdorues i të cilave është subjekti rezulton të ketë në total 0 (zero) lekë detyrime për faturat e energjisë elektrike, përfshirë faturën koherente të muajit Janar 2026.

KSHA gjykon se, vërtetimi është lëshuar përpara hapjes së ofertave nga ana e Autoritetit Kontraktor dhe me anë të tij provohet se operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike. Referuar pikës 2 të nenit 82 të VKM-së Nr.285.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" (i ndryshuar), përcaktohet se:

"Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme".

KSHA gjykon se, operatori ekonomik i kualifikuar "S I L V E R" shpk plotëson me anë të dokumentacionit provues pranë AK, kriterin e përgjithshëm të sipërcituar në DST.

Për sa më sipër, KSHA gjykon se pretendimi i Operatorit ekonomik "REJ"sh.p.k nuk qëndron.

5. Lidhur me pretendimin e mëposhtëm:

"Në pikën 2.3.4 të DT-ve, përcaktohet se: "Përveç inxhinierit të sipërpërmendur, duhet të rezultojnë të punësuar me kontrata pune të vlefshme edhe 2 (dy) drejtues mjetesh të rënda të pajisur me CAP, si personel i domosdoshëm për kryerjen e shërbimit". Operatori Silver shpk nuk disponon dy drejtues mjetesh të cilët të jenë të pajisur me CAP. Kompania Silver është një kompani e cila është e angazhuar në fushën e shërbimit të ushqimit catering dhe në të gjitha procedurat që janë zhvilluar ky subjekt nuk rezulton të ketë marre pjesë në ato tendera ku kërkohen drejtues mjetesh të rënda të pajisur me CAP".

Në vijim, KSHA pasi shqyrtoi parashtrimet dhe pretendimet e operatorit ekonomik ankimues, dokumentacionin që administrohet në dosjen e procedurës së prokurimit dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi, gjykon se:

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar, KSHA konstaton se referuar Shtojcës 9 të Dokumentave Standarte të Tenderit, pika 2.3.3 "Kriteret e Veçanta të Kualifikimit" është përcaktuar si më poshtë vijon:

"2.3.3 Përveç inxhinierit të sipërpërmendur, duhet të rezultojnë të punësuar me kontrata pune të vlefshme edhe 2 (dy) drejtues mjetesh të rënda të pajisur me CAP, si personel i domosdoshëm për kryerjen e shërbimit.

Shënim: *Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit sipas Shtojcës 9. Operatori ekonomik i kualifikuar i pari në klasifikim duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit. Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të kryejë të gjithë verifikimet e nevojshme për të vërtetuar deklarimin e mësipërm".*

Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar pranë Autoritetit Kontraktor rezulton se, operatori ekonomik "S I L V E R" shpk, në përmbushje të kriterit të veçantë 2.3.3, të përcaktuar në Dokumentat Standarte të Tenderit ka dorëzuar dokumentacionin provues të noterizuar me Nr.REP 1765 datë 04.03.2026, ku bashkëlidhet Kontrata Individuale e Punës, me datë 17.03.2025, e lidhur mes subjektit "S I L V E R" shpk dhe punonjësit Z. Mariglen Bitri, në pozicionin Shofer Kamioni i shoqëruar me patentën personale ku figuron kodi 95, i cili provon se punonjësi është i pajisur me CAP, për drejtimin e mjeteve të rënda.

Gjithashtu, në përmbushje të kriterit të veçantë 2.3.3 të përcaktuar në Dokumentat Standarte të Tenderit ka dorëzuar dokumentacionin provues të noterizuar me Nr.REP 1765 datë 04.03.2026, ku bashkëlidhet Kontrata Individuale e Punës, me datë 03.05.2019, e lidhur mes subjektit "S I L V E R" shpk dhe punonjësit Z. Sokol Kllogjeri, në pozicionin Shofer Kamioni i shoqëruar me patentën personale ku figuron kodi 95, i cili provon se punonjësi është i pajisur me CAP, për drejtimin e mjeteve të rënda.

KSHA gjykon se, vërtetimi është lëshuar përpara hapjes së ofertave nga ana e Autoritetit Kontraktor dhe me anë të tij provohet se operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike. Referuar pikës 2 të nenit 82 të VKM-së Nr.285.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" (i ndryshuar), përcaktohet se:

"Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme".

KSHA gjykon se, operatori ekonomik i kualifikuar "S I L V E R" shpk plotëson me anë të dokumentacionit provues pranë AK, kriterin e përgjithshëm të sipërcituar në DST.

Për sa më sipër, KSHA gjykon se pretendimi i Operatorit ekonomik "REJ"sh.p.k nuk qëndron.

6. Lidhur me pretendimin e mëposhtëm:

"Në pikën 2.3.6 të DT-ve, është përcaktuar kriteri si më poshtë: 2.3.6 Kandididati/ operatori ekonomik duhet të paraqesë kapacitetet e mëposhtme teknike që nevojiten për ekzekutimin e kontratës:

Operatori Silver nuk plotëson kërkesën për disponimin e një "Makinë teknologjike transportuese, me ngarkim fundor ose anësor, me kapacitet mbajtës 4-5 ton, raport kompaktimi 1:4 - 1:6". Dokumentacioni i paraqitur nga Silver shpk për plotësimin e këtij kriteri nuk provon disponimin e një makine teknologjike me karakteristikat e kerkuara ne kete kriter. Operatori Silver nuk plotëson

kërkesën për disponimin e një "Makinë vetëshkarkuese, me hapje të spondit anësor ose nga pas, për grumbullimin dhe transportimin e mbetjeve dhe mirëmbajtje të parkimeve gjatë ditës, me kapacitet mbajtës 2 ton". Dokumentacioni i paraqitur nga Silver shpk per plotesimin e ketij kriteri nuk provon disponimin e nje makine me karakteristikat e kerkuara ne kete kriter. Operatori Silver nuk ploteson kërkesën për disponimin e 4 "Makineri fshesa korenti per siperfaqet e brendshme (tek parkimet nentokesore)". Dokumentacioni i paraqitur nga Silver shpk per plotesimin e ketij kriteri nuk provon disponimin e nje makine me karakteristikat e kerkuara ne kete kriter".

Në vijim, KSHA pasi shqyrtoi parashtrimet dhe pretendimet e operatorit ekonomik ankimues, dokumentacionin që administrohet në dosjen e procedurës së prokurimit dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi, gjykon se:

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar, KSHA konstaton se referuar Shtojcës 9 të Dokumentave Standarte të Tenderit, pika 2.3.6 "Kriteret e Veçanta të Kualifikimit" është përcaktuar si më poshtë vijon:

"2.3.6 Kandididati/ operatori ekonomik duhet të paraqesë kapacitetet e mëposhtme teknike që nevojiten për ekzekutimin e kontratës:

Lista e makinerive që duhet të disponoje operatori ekonomik të përmbledhura në tabelen e mëposhtme:

Nr.	Lloji i pajisjeve	Njësia	Sasia	Pronesi/Qera
1	Makinë teknologjike transportuese, me ngarkim fundor ose anësor, me kapacitet mbajtës 4-5 ton, raport kompaktimi 1:4 - 1:6.	copë	1	Pronesi/Qera
2	Makinë teknologjike e vogel (autofshese) për fshirjen e rrugëve, të pajisur me 2 fshesa anësore (majtas dhe djathtas) dhe një fshesë qendrore rrul, sistem thithës të pluhurave (aspirator) dhe sistem spërkatje me ujë gjatë punës, me tub aspirimi të jashtëm thithës.	copë	1	Pronesi/Qera
3	Makinë vetëshkarkuese, me hapje të spondit anësor ose nga pas, për grumbullimin dhe transportimin e mbetjeve dhe mirëmbajtje të parkimeve gjatë ditës, me kapacitet mbajtës 2 ton.	copë	1	Pronesi/Qera
4	Makineri pompe speciale per larje dyshemeje.	copë	1	Pronesi/Qera
5	Autobot uji per larjen me kapacitet mbajtës 9000-10000 litra.	copë	1	Pronesi/Qera
6	Makineri speciale per fshirjen e pllakave.	copë	1	Pronesi/Qera
7	Makineri fshesa korenti per siperfaqet e brendshme(tek parkimet nentokesore).	copë	4	Pronesi/Qera

Shënim: Për Makineritë dhe Mjetet teknologjike të kërkuara më sipër, duhet të paraqitet dokumentacioni si më poshtë:

- Mjetet në pronësi shoqërohen me akt pronësie origjinal ose kopje të noterizuar (kontrata shitblerje ose kontrata dhurimi).
- Mjetet me qira shoqërohen me kontratë qiraje, si dhe me aktin e pronësisë së qiradhënësit (origjinal ose kopje e noterizuar).
- Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin si leje qarkullimi, certifikatën e pronësisë, certifikatën e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit, certifikatën e transportit (të vlefshme) dhe foto.

- *Për mjetet me qera, duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e tij, certifikatën e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit (të vlefshme) dhe foto duhet të shoqërohet me kontratën përkatëse të qerasë/furnizimit. Në rastin e mjeteve të tjera duhet të jenë aktet e çdoganimit ose faturat tatimore të blerjes.*
- *Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë me shkrim se mjetet e paraqitura janë në përputhje me specifikimet teknike, pjesë përbërëse e këtyre dokumenta tenderi.*
- *Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë me shkrim për disponueshmërinë e mjeteve gjatë gjithë periudhës së kryerjes së shërbimit.*
- *Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë ku, Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të kryejë në çdo kohë verifikimin fizik të disponueshmërisë së mjeteve, me apo pa lajmërim paraprak, si dhe të beje deklarin e adreses se sakte te vendodhjes se mjeteve me qellim verifikimin e tyre”.*

Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar pranë Autoritetit Kontraktor rezulton se, operatori ekonomik “S I L V E R” shpk, në përmbushje të kriterit të veçantë 2.3.6 ka dorëzuar dokumentacionin provues si më poshtë:

Vërtetim Njësie me origjinalin me Nr.REP 1766 datë 04.03.2026 për dokumentacionin provues të: Makinë teknologjike transportuese, me ngarkim fundor ose anësor, me kapacitet mbajtës 4-5 ton, raport kompaktimi 1:4 - 1:6 (*Kontratë qeraje mes Shoqërisë DIEN shpk dhe S I L V E R shpk, certifikatën e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit (të vlefshme), foto dhe deklaratë për përmbushjen e specifikimeve teknike*);

Makinë vetëshkarkuese, me hapje të spondit anësor ose nga pas, për grumbullimin dhe transportimin e mbetjeve dhe mirëmbajtje të parkimeve gjatë ditës, me kapacitet mbajtes 2 ton (kopje e noterizuar e aktit të pronësisë; *leje qarkullimi, certifikatën e pronësisë, certifikatën e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit, certifikatën e transportit (të vlefshme), foto dhe deklaratë për përmbushjen e specifikimeve teknike*).

Makineri fshesa korenti për sipërfaqet e brendshme (tek parkimet nëntokësore) (*Kontratë qeraje mes Shoqërisë Toifor shpk dhe S I L V E R shpk, Kontratë qeraje mes Shoqërisë AIR shpk dhe S I L V E R shpk; foto dhe deklaratë për përmbushjen e specifikimeve teknike*).

KSHA gjykon se, dokumentacioni i dorëzuar nga ana e OE provon se zotëron të gjitha mjetet e nevojshme për kryerjen e shërbimit, objekt prokurimi dhe të përcaktuara në kriterin 2.3.6 të DST. Referuar pikës 2 të nenit 82 të VKM-së Nr.285.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), përcaktohet se:

“Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme”.

KSHA gjykon se, operatori ekonomik i kualifikuar “S I L V E R” shpk plotëson me anë të dokumentacionit provues pranë AK, kriterin e sipërcituar në DST.

Për sa më sipër, KSHA gjykon se pretendimi i Operatorit ekonomik “REJ” sh.p.k nuk qëndron.

7. Lidhur me pretendimin e mëposhtëm:

“Të mbeten të skualifikuar operatorët Pastrime Silvio shpk dhe Clean Fast shpk. Si arsye skualifikimi t’u shohen dhe mugesat e dorezimit te vertetimeve te energjise elektrike dhe vertetimit

te gjendjes gjyqesore te cilat janë me datë pas datës së hapjes së ofertave. Sipas nenit 26 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, kërkohet që dokumentat e tenderit duhet të përmbajnë gjendjen faktike të datës së hapjes së ofertave”.

Në vijim, KSHA pasi shqyrtoi parashtrimet dhe pretendimet e operatorit ekonomik ankimues, dokumentacionin që administrohet në dosjen e procedurës së prokurimit dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi, gjykon se:

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar, KSHA konstaton se të dy operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, **“Pastrime Silvio” shpk** dhe **“CLEAN FAST” shpk** janë skualifikuar për arsye të mospërmbushjes së kriteve të veçanta të kualifikimit, të përcaktuara në Dokumentat Standarte të Tenderit.

Përsa i takon pretendimeve të operatorit ekonomik ankimues konstatojmë se në fazën në të cilën është bërë vlerësimi, KVO ka shqyrtuar dokumentacionin e dorëzuar në SPE dhe vetëdeklarimet e bëra në Formularin Përmbledhës (Shtojca 10), referuar pikës 1 të nenit 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, të ligjit Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” (i ndryshuar), përcaktohet se: *“1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik. Kur autoriteti ose enti kontraktor mund t'i marrë dokumentet mbështetëse duke u futur direkt në një bazë të aksesueshme të dhënash shtetërore, në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit përcaktohet edhe informacioni që kërkohet për këtë qëllim, siç është adresa në internet e bazës të të dhënave, çdo e dhënë identifikimi dhe, sipas rastit, në deklaratën e nevojshme për dhënien e pëlqimit. Operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm”.*

Në nenin 94, pika 1, të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar) parashikohet se: *“Çdo operator ekonomik, i cili ka ose ka pasur interes të ligjshëm 84në një procedure prokurimi sipas LPP, dhe kur është dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga veprimet ose mosveprimet e autoritetit/entit kontraktor, për të cilat pretendon se janë në kundërshtim me ligjin, ka të drejtë të ankohet pranë autoritetit/entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik”.*

KSHA gjykon se interesi i ligjshëm i operatorëve për të paraqitur ankim pranë autoritetit kontraktor, si edhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik duhet të jetë dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga një vendim i marrë nga autoriteti kontraktor në kundërshtim me ligjin e prokurimit publik. Një ankimues do të konsiderohet i dëmtuar apo disavantazhuar, kur ai rrezikon dukshëm të mos arrijë të kualifikohet si pasojë nga veprimi i autoritetit kontraktor dhe kjo rregullohet përmes ankimit në AK dhe KPP. Në rastin konkret, konstatohet se operatorët ekonomikë **“Pastrime Silvio” shpk** dhe **“CLEAN FAST” shpk**, rezultojnë të skualifikuar nga autoriteti kontraktor dhe prej tyre nuk është paraqitur asnjë ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit/entit kontraktor për kundërshtimin e skualifikimit të tyre në përputhje me ligjin dhe rregullat e prokurimit publik.

Sa më sipër, KSHA vlerëson se ankimuesi "REJ" SHPK nuk legjitimohet për të kundërshtuar skualifikimin e operatorëve të tjerë ofertues në procedurën e prokurimit, pasi nuk ka interes të ligjshëm për pretendimin e ngritur ndaj operatorëve ekonomik të sipërcituar, sepse fati i tyre është tashmë i përcaktuar si i skualifikuar nga procedura e prokurimit nga autoriteti kontraktor për mospërbushje të kriterëve të parashikuara në DST dhe mbi të gjitha pozita e tyre do të vijojë i skualifikuar dhe për faktin se nuk kanë paraqitur ankesë për procedurën objekt prokurimi, pra gjendja e tij faktike dhe juridike do të vijojë mbetet i skualifikuar.

Për sa më sipër, KSHA gjykon se pretendimi i Operatorit ekonomik "REJ"sh.p.k nuk qëndron.

Në përfundim gjykojmë se bazuar në nenin 92 pika 3 të LPP-së ku përcaktohet se: "*Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit...*",

V. Konkluzionet e Shqyrtimit të Ankesës:

Personi i ngarkuar për Shqyrtimin e Ankesës pas shqyrtimit dhe vlerësimit të ankesës dhe pretendimeve të operatorit ekonomik ankimues "REJ" shpk arrin në konkluzionin se:

Pretendimet e operatorit ekonomik ankimues "REJ" shpk nuk qëndrojnë.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 114, pika 3 të Ligjit Nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik" (i ndryshuar), dhe nenit 102, pika 1, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" (i ndryshuar);

VENDOSI:

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik "REJ" shpk për procedurën e prokurimit me objekt: "**Shërbime të Pastrimit**" me Nr. REF-75943-02-12-2026.
2. Autoriteti Kontraktor do të vërë në dijeni për vendimin e marrë Komisionin e Prokurimit Publik, palën ankimuese, për marrjen e këtij vendimi.
3. Një kopje e vendimit i komunikohet me shkrim ankimuesit dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dhe dokumentacionit bashkëngjitur saj,

Arsyeton:

III.1. Para shqyrtimit në themel të pretendimeve të operatorit ekonomik ankimues "Rej" SHPK mbi vendimarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e tij nga procedura e prokurimit me pretendimin se nuk përmbush kriterin 2.2.4 të kapacitetit ekonomik dhe financiar në kriteret e veçanta të kualifikimit, Komisioni i Prokurimit Publik në zbatim të nenit 29, pika 2 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 "*Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*", në të cilin parashikohet se "*1. Komisioni shqyrton ankesën brenda objektit dhe shkaqeve të parashtruara në ankesë. 2. Përjashtimisht, kur ka lidhje midis objektit të ankesës dhe vendimeve*

apo veprimeve të tjera të autoritetit kontraktor gjatë procedurës së prokurimit, Komisioni vendos edhe për ligjshmërinë e tyre”, nisur nga pretendimet e operatorit ekonomik “Rej” SHPK gjykon të ndalet fillimisht në ligjshmërinë e veprimeve të autoritetit kontraktor, për sa kohë që objekti i ankesës ka lidhje me vendimet dhe veprimet e ndërmarra kryesisht nga autoriteti kontraktor, gjatë zbatimit të hapave të mëtejshëm të procedurës së prokurimit objekt-ankimi.

III.1.1. Marrë shkas nga pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Rej” SHPK, nga verifikimi i kriterit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor në pikën 2.2.4 të kapacitetit ekonomik dhe financiar në kriteret e veçanta të kualifikimit, në bazë të të cilit është bërë më pas edhe shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave, Komisioni i Prokurimit Publik, konstaton se ky kriter është hartuar në kundërshtim me legjislacionin në fuqi për prokurimin publik dhe konkretisht:

III.1.2. Në shtojcën 9 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, “2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar”, pika 2.2.4 e dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

2.2.4 Vërtetim i lëshuar nga shoqëria “Ujësjetllës Kanalizime Tiranë” sha, i cili konfirmon pagesën e të gjitha detyrimeve që rrjedhin nga kontratat e furnizimit me ujë. (Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit). Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr. 10 të Dokumentave Standarte të Tenderit, Autoriteti/enti Kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese.

Ndërsa në shtojcën 10 të dokumenteve standarde të tenderit autoriteti kontraktor ka parashikuar

Shtojca 10

FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

Unë i nënshkruari _____ në cilësinë e _____ të operatorit ekonomik _____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

A. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik

<i>Identifikimi</i>	<i>Përgjigja</i>
----------------------------	-------------------------

Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE)	-----
Numri NIPT/et:	-----
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	-----
Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	-----
E-mail:	-----

B: DEKLARATË

Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- Informacione për nënkontraktorin***

<i>Emri i nënkontraktorit të propozuar</i>	<i>NIPT –i</i>	<i>Përqindja e nënkontraktimit</i>	<i>Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t'u nënkontraktuar</i>

- Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik***

<i>Emri (at) e subjekteve</i>	<i>NIPT-i</i>	<i>Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik</i>	<i>Specifiko konkretisht kapacitetin/et</i>

Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata
<p>Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.</p> <p>Sqarimene vlerësohet e nevojshme _____</p>
<p>Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së.</p> <p>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____</p>
<p>Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:</p> <p>_____</p> <p>_____</p> <p>etj.</p> <p>nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë të dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj.</p> <p>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____</p>
<p>Operatori ekonomik nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi</p> <p>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____</p>
<p>Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).</p>

<p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____</i></p>
<p><i>Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së.</i></p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____</i></p>
<p><i>Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi.</i></p> <p><i>Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.</i></p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____</i></p>
<p><i>Operatori Ekonomik nuk ka shfaqur mangësi të rëndësishme apo të vazhdueshme në përmbushjen e një kritერი thelbësor të një kontrate të mëparshme me një autoritet ose ent kontraktor apo një kontrate koncesionare që ka çuar në përfundimin e kësaj kontrate.</i></p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet nevojshme _____</i></p>
<p><i>Operatori ekonomik ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.</i></p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____</i></p>
<p><i>Operatori ekonomik i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë.</i></p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____</i></p>
<p><i>Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së.</i></p> <p><i>Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.</i></p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____</i></p>
<p><i>Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi.</i></p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____</i></p>

B: DEKLARATA “Për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura”

Në cilësinë e përfaqësuesit të operatorit ekonomik, Deklaroj Se:

Jam në dijeni të pasojave që vinë ndaj meje lidhur me këtë Deklaratë, në respektim të ligjit nr. 9121/2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar.

Kam përgatitur ofertën në mënyrë të pavarur, pa bërë marrëveshje apo pa rënë dakord me asnjë konkurrent tjetër¹.

Në veçanti, pa kufizuar si më lart, nuk kam pasur kontratë apo marrëveshje me ndonjë konkurrent me qëllim cënimin e konkurrencën, në lidhje me:

*çmimet;
metodat, faktorët ose formulat e përdorura për llogaritjen e çmimit;
qëllimin apo vendimin për të paraqitur apo jo një ofertë; ose,
paraqitjen e një oferte që nuk i plotëson specifikimet e kërkesës për ofertë.*

Nuk kam pasur marrëveshje apo kontrata me ndonjë konkurrent, me qëllim cënimin e konkurrencës, në lidhje me cilësinë, sasinë, specifikimet apo dërgesa të veçanta të produkteve apo shërbimeve të cilat lidhen me prokurimin në fjalë.

Kushtet e ofertës nuk u janë bërë të njohura dhe as nuk do t’u bëhen të njohura, me qëllim cënimin e konkurrencës, në çdo mënyrë qoftë, konkurrentëve të tjerë, para datës dhe kohës së hapjes zyrtare të ofertave, shpalljes fitues dhe lidhjes së kontratës, vetëm nëse kërkohet me ligj.

C: DEKLARATA “Mbi Konfliktin e Interesit”

Deklarata

Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se jemi të vetëdijshëm për sa vijon:

Konflikti i interesit është një situatë e konfliktit midis detyrës publike dhe interesit privat të një zyrtari, në të cilën ai / ajo ka interesa private direkte ose indirekte që ndikojnë, ose që mund të ndikojë ose që duket se ndikojnë në kryerjen e padrejtë të detyrave dhe detyrimeve publike.

Në përputhje me nenin 21, paragrafi 1, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005, kategoritë e zyrtarëve siç parashikohen në Kapitullin III, Seksioni II, që janë absolutisht të ndaluara të përfitojnë drejtpërdrejt ose indirekt nga nënshkrimi i kontratave midis një pale dhe institucionit publik janë:

- Presidenti i Republikës, Kryeministri, Zëvendës Kryeministri, Ministrat, ose Zëvendësministrat, Deputetët, Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, Kreu i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Prokurori i Përgjithshëm, Gjyqtarët dhe Prokurorët në nivelin e Gjykatës së Shkallës së Parë dhe Gjykatës së Apelit, Avokati i Popullit, Anëtarët e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit, Anëtarët e Enteve Rregullatore (Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, përfshirë Guvernatorin dhe Zëvendësguvernatorin; konkurrenca; telekomunikacioni; energjia elektrike; furnizimi me ujë; sigurimi; bonot; autoritetet e

¹ Për qëllim të kësaj deklarate dhe ofertës së paraqitur, fjala “konkurrentë” nënkupton çdo operator tjetër ekonomik, të ndryshëm nga Ofertuesi, të paraqitur ose jo si bashkim operatorësh ekonomik, që: a) paraqesin një ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë, të bërë nga Autoriteti Kontraktor; b) është një ofertues i mundshëm, i cili bazuar në kualifikimin, aftësitë ose përvojat e tij, mundet të dorëzojë një ofertë në përgjigje, të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë.

medias), sekretarët e përgjithshëm të institucioneve qendrore si dhe çdo zyrtar publik në çdo institucion publik pozicioni i të cilit është i barabartë me atë të Drejtorit i Përgjithshëm, drejtuesit e organeve të administratës publike që nuk janë pjesë e shërbimit civil.

- Për nëpunësit civilë të nivelit të mesëm, sipas nenit 31 dhe zyrtarët sipas nenit 32 të kreut III, seksionit 2 të këtij ligji, ndalimi në paragrafin 1 të këtij neni, për shkak të interesave private të zyrtarit, siç përcaktohet këtu të zbatohet vetëm në rast të lidhjes së kontratave brenda fushës dhe territorit të institucionit dhe juridiksionit të institucionit, ku punon zyrtari. Ky ndalim do të zbatohet edhe kur pala në kontratë është një institucion varësie.

Kur zyrtari është kryetar bashkie ose nënkryetar i një bashkie ose komune, ose kryetar i një këshilli rajonal, anëtar i këshillit përkatës, ose një zyrtar i lartë i menaxhimit të një njësie të qeverisjes vendore, ndalimi për shkak të interesave private të zyrtarit, specifikuar këtu, do të zbatohet vetëm në rastin e lidhjes së kontratave, nëse ka, me bashkinë, komunën ose rajonin ku zyrtari ushtron një detyrë të tillë. Ky ndalim do të zbatohet gjithashtu kur pala në kontratë është një institucion publik në varësi të kësaj njësie (neni 21, paragrafi 2, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005).

Ndalimet e parashikuara në nenin 21, paragrafët 1, 2 të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, me përjashtimet përkatëse, do të zbatohen në të njëjtën masë edhe për personat e lidhur me zyrtarin, d.m.th. **bashkëshortin, bashkëjetuesin, fëmijët madhorë e prindërit e zyrtarit dhe të bashkëshortit dhe bashkëjetuesit.**

Unë jam në dijeni të kërkesave dhe ndalimeve të parashikuara në Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005 "Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcioneve Publike", të ndryshuar, dhe aktet nënligjore të miratuara në bazë të tij nga Inspektorati i Lartë i Deklarimi dhe Kontrolli i Pasurive, si dhe Ligji Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik".

Në përputhje me to, unë deklaroj këtu se asnjë zyrtar publik, siç përcaktohet në Kapitullin III, Seksioni II të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, dhe në këtë deklaratë, nuk ka ndonjë interes privat, direkt ose indirekt, me personin juridik që unë përfaqësoj këtu.

D: DEKLARATA "Për zbatimin e dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës"

Deklarata

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- Operatori ekonomik _____garanton mbrojtjen e të drejtës së punësimit dhe profesionit nga çdo formë diskriminimi, të parashikuar nga legjislacioni i punës në fuqi.
- Operatori ekonomik _____lidh me punëmarrësit kontratat përkatëse të punës dhe garanton masat në drejtim të sigurisë dhe shëndetit në punë për të Gjithë dhe, në mënyrë të veçantë, për grupet e rrezikuara, bazuar në legjislacionin e punës në fuqi.
- Operatori ekonomik _____nuk ka masë Ligjore në fuqi, të vendosur nga Inspektoriati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (ISHPSHSH). Në rastet kur janë konstatuar shkelje ligjore, operatori ekonomik ka marrë masat e nevojshme për adresimin e tyre, brenda afateve të përcaktuara nga ISHPSHSH.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Pjesa III Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit

A: DEKLARATË “Në përputhje me specifikimet teknike dhe grafikun e realizimit të objektit të kontratës”

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se plotësojnë të gjitha specifikimet teknike, siç udhëzohet në dokumentet e tenderit, dhe këtë e provojmë përmes certifikatave dhe dokumenteve të paraqitura me këtë deklaratë (nëse kërkohet nga Autoriteti Kontraktor), dhe marrim përsipër të realizojmë objektin në përputhje me Listën e mallrave dhe grafikun e lëvrimit të përcaktuar nga Autoriteti kontraktor.	Po [] Jo []

B: DEKLARATË

Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen)

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se: Unë kam punonjësit e nevojshëm si dhe mjetet dhe makineritë për ekzekutimin e kontratës, siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoj këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar nëse	<u>Punonjës</u> Po [] Jo [] Nëse, po, numri i punonjësve: _____

<p><i>fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.</i></p>	<p><i>Profili i punonjësve</i></p> <hr/> <p><i><u>Makineri e mjete</u></i></p> <p><i>Po [] Jo []</i></p> <p><i>Nëse po, të listohen me të dhënat konkrete:</i></p> <hr/>
<p><i>Emri, Mbiemri</i> _____</p> <p><i>Firma</i> _____</p> <p><i>Vula</i> _____</p> <p><i>Data e dorëzimit të deklaratës</i> _____</p>	

Ju lutemi sigurohuni që:

- *Secili pjesëmarrës i renditur në një bashkim operatorësh ekonomikë të paraqesë një Formular të veçantë të Vetëdeklarimit.*
- *Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, një Formular i veçantë i Vetëdeklarimit duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.*
- *Çdo vetdeklarim i pavërtetë/pasaktë nga ana e operatorëve ekonomikë jo vetëm që përbën shkak për skualifikimin nga procedura konkrete, por përbën shkak dhe për përjashtimin e tyre nga e drejta për të fituar kontrata publike deri në 3 vjet, sipas parashikimeve të ligjit për prokurimin publik.*
- *Operatorët ekonomikë që ofertojnë në procedurat e prokurimit të vetdeklarojnë në çdo rast informacionin e saktë që i korrespondon gjendjes së tyre faktike.*

Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik për sa më sipër.

- *Në procedurat e prokurimit me një fazë, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti kontraktor i kërkon ofertuesit te kualifikuar i pari që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike.*

- Në procedurat e prokurimit me faza, ky dokumentacion i kërkohet të gjithë kandidatëve të kualifikuar në fazën e parë, përpara nisjes së afateve të ankimit.
- Ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, për dokumentat e ofertës të ngarkuara në Sistemin e Prokurimit Elektronik duhet të dorëzojë dokumentat provuese, të cilat duhet të jenë në origjinal ose në kopje të njehsuara. Ndërsa, dokumentet provuese, që do të paraqiten për të provuar vetëdeklarimet e bëra, duhet të paraqiten në origjinal ose të njësuar me origjinalin dhe të provojnë gjendjen faktike të ofertuesit në kohën e ofertimit të tij.
- Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.

III.1.3. Në procesverbalin për argumentimin e kriterëve për kualifikim dhe specifikimeve teknike ky kriter është përcaktuar dhe argumentuar si vijon:

2.2.4 Vërtetim i lëshuar nga shoqëria “Ujësjellës Kanalizime Tiranë” sha, i cili konfirmon pagesën e të gjitha detyrimeve që rrjedhin nga kontratat e furnizimit me ujë. (Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit). Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhes të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr. 10 të Dokumentave Standarte të Tenderit, Autoriteti/enti Kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar sipas Nenin 41, pika 6 të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku përcaktohet se “Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriterë të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”. Bashkia Tiranë nëpërmjet “Ujësjelles Kanalizime Tiranë” sha ka si objektiv kryesor garantimin e shërbimeve jetike të furnizimit me ujë në territorin e Bashkisë Tiranë, ku dhe një nga prioritet bazë është mbledhja e të gjithë detyrimeve që rrjedhin nga kontratat e furnizimit me ujë. Qëllimi i vendosjes së këtij kriteri është për të siguruar Autoritetin Kontraktor që për dhënien e kontratës të kontraktohen operatorë ekonomik të cilët nuk kanë detyrime të pashlyera për furnizimit me ujë sipas objektin ku ushtrojnë aktivitetin, në Bashkinë e Tiranës. Vendosja e këtij kriteri siguron institucionin e Tirana Parking edhe në rast detyrimesh të pashlyera, operatorët ekonomik kanë periudhën e nevojshme kohore për të shlyer këto detyrime përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit. Vendosja e këtij kriteri është propocion me objektin e kontratës, për sa kohë është detyrim i cdo shoqërie shlyerja e detyrimeve të shërbimeve të furnizimit me ujë në territorin ku ushtron aktivitetin, konkretisht Bashkia Tiranë.

III.1.4. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”

III.1.5. Ndërkohë në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet shprehimisht se:

- “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.
2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.
3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”

III.1.6. Në nenin 77 të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë.

Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.

Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

III.1.7. Në pikat 1 dhe 2 të nenit 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar përcaktohet se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik. Kur autoriteti ose enti kontraktor mund t'i marrë dokumentet mbështetëse duke u futur direkt në një bazë të aksesueshme të dhënash shtetërore, në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit përcaktohet edhe informacioni që kërkohet për këtë qëllim, siç është adresa në internet e bazës të të dhënave, çdo e dhënë identifikimi dhe, sipas rastit, në deklaratën e nevojshme për dhënien e pëlqimit. Operatorët

ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm. 2. Në çdo kohë gjatë procedurës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë ofertuesve dhe kandidatëve sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, kur kjo është e nevojshme për të garantuar zbatimin korrekt të procedurës.”

III.1.8. Në nenin 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, pikat 1, 2, 3, 6 dhe 7 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet se: 1. *Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.*

2. *Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarin, si më poshtë vijon:*

a) *operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;*

b) *operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;*

c) *personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;*

ç) *operatori ekonomik nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;*

d) *operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi;*

dh) *operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së;*

e) *operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohe për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë;*

ë) *operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;*

f) *operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës;*

g) *operatori ekonomik ka paraqitur ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;*

gj) *operatori ekonomik përmbush specifikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor;*

h) *operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti);*

i) *operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti;*

j) informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do të mbështetet, nëse është rasti dhe nënkontraktorët e mundshëm, nëse është rasti;

k) operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kërkesave të legjislacionit në fuqi;

l) operatori ekonomik ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi;

ll) operatori ekonomik i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë.

3. Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.

6. Në procedurat e prokurimit me një fazë, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i” dhe “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.

Në procedurat e prokurimit me faza, ky dokumentacion i kërkohet të gjithë kandidatëve të kualifikuar në fazën e parë, përpara nisjes së afateve të ankimit.

Ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të dorëzojë dokumentat provuese, të cilat duhet të jenë në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.

Për dokumentat e ofertës, të ngarkuara në sistemin e prokurimit elektronik, ofertuesi i kualifikuar i pari duhet t'i paraqesë këto dokumenta në origjinal ose të njësuar me origjinalin.

Gjithashtu, dokumentet provuese, që do të paraqiten për të provuar vetëdeklarimet e bëra, duhet të paraqiten në origjinal ose të njësuar me origjinalin dhe të provojnë gjendjen faktike të ofertuesit në kohën e ofertimit të tij.

Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike.

Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj. Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.

7. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.”

III.1.9. Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën

e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi ndaj dhe përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim dhe specifikimet teknike janë lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktor, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin dhe natyrën e kontratës së prokurimit.

III.1.10. Komisioni i Prokurimit Publik, sa më sipër analizuar, gjykon, se autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi. Në këtë kuadër, përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim dhe specifikimeve teknike, është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktues, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës objekt-prokurimi, si dhe aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Marrë shkas nga pretendimet e ankimesit i cili kundërshton skualifikimin e tij nga procedura e prokurimit objekt ankimi pasi sipas KVO nuk plotëson kriterin për vërtetimin e lëshuar nga shoqëria “Ujësjetllës Kanalizime Tiranë” sha, i cili konfirmon pagesën e të gjitha detyrimeve që rrjedhin nga kontratat e furnizimit me ujë, siç është kërkuar në pikën 2.2.4 të kapacitetit ekonomik dhe financiar në kriteret e veçanta të kualifikimit në dokumentet standarde të tenderit, KPP vëren se në kriterin e veçantë të kualifikimit, autoriteti kontraktor ka kërkuar:

2.2.4 Vërtetim i lëshuar nga shoqëria “Ujësjetllës Kanalizime Tiranë” sha, i cili konfirmon pagesën e të gjitha detyrimeve që rrjedhin nga kontratat e furnizimit me ujë. (Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit). Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhes të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr. 10 të Dokumentave Standarde të Tenderit, Autoriteti/enti Kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese.

Referuar pretendimeve të operatorit ekonomik ankimes “Rej” SHPK të paraqitura në ankesë pasi sipas KVO nuk përmbush kriterin e përcaktuar në pikën 2.2.4 të kapacitetit teknik në kriteret e vecanta të kualifikimit, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se është me vend të ndalet në faktin nëse kriteri në fjalë i hartuar nga autoriteti kontraktor në lidhje me vërtetimin e lëshuar nga shoqëria “Ujësjetllës Kanalizime Tiranë” sha, i cili konfirmon pagesën e të gjitha detyrimeve që rrjedhin nga kontratat e furnizimit me ujë, kriter që sipas autoritetit kontraktor do të konsiderohet i përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit, është në përputhje me parashikimet e dispozitave ligjore dhe nënligjore në fuqi në fushën e prokurimit publik apo jo.

Referuar parashikimeve të nenit 82 të *lex specialis* si dhe nenit 26 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” e ndryshuar, janë përcaktuar kriteret e kualifikimit të cilat plotësohen me formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të cilin në zbatim të parashikimeve ligjore në fuqi autoriteti/enti kontraktor e pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, dhe vetëm përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i

kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i” dhe “j” të pikës 2 të nenit 26 të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike, duke i rezervuar në këtë mënyrë të drejtën autoritetit kontraktor të kryejë verifikime në rast nevojë apo të dërgojë kërkesa për sqarim mbi dokumentacionin e paraqitur nga operatorët ekonomikë.

Nga verifikimet rezulton, se kriteri i hartuar nga autoriteti kontraktor në lidhje me paraqitjen në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të vërtetimit të lëshuar nga shoqëria “Ujësjetllës Kanalizime Tiranë” sha, i cili konfirmon pagesën e të gjitha detyrimeve që rrjedhin nga kontratat e furnizimit me ujë, nuk është në përputhje me nenin 82 të LPP dhe nenin 26, pika 2 të VKM nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, pasi nuk përfshihet në asnjërin prej rubrikave të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit. Në bazën ligjore të sipërcituar përcaktohet qartë se cilat janë kriteret e kualifikimit të cilat plotësohen me formularin përmbledhës të vetëdeklarimit dhe si rrjedhim kriteri i hartuar në këtë mënyrë ka sjellë konfuzion si në përgatitjen e ofertave nga operatorët ekonomik ashtu edhe te organet e vlerësimit të ofertave dhe shqyrtimit të ankesave.

Sa më sipër, autoriteti kontraktor duhet të marrë masa për anulimin e procedurës së prokurimit objekt – ankimi, si dhe në rishpalljen e saj të mbajë në konsideratë, parashikimet e 82 të LPP dhe nenit 26, pika 2 të VKM nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” e ndryshuar, pasi është në të drejtën e autoritetit kontraktor, hartimi i kriterëve për kualifikimin, por këto të fundit duhet të jenë jodiskriminuese, të qarta, jo konfuze , si dhe në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi për prokurimin publik dhe legjislacionin sektorial në fuqi. KPP gjykon, se vetë ligjvënësi ka parashikuar në nenin 2 gërma “dh”, se qëllimi i ligjit të prokurimit publik është ndër të tjera të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik. Ashtu si edhe Gjykata Europiane e Drejtësisë (GJED) ka nënvizuar ndër vite, parimi i transparencës dhe barazisë janë të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën, por detyra thelbësore e transparencës në një procedurë prokurimi është që të krijohen kushte dhe rregulla të hollësishme për të gjitha palët në proces. KPP i sjell në vëmendje autoritetit kontraktor që në hartimin e kriterëve për kualifikim duhet t’i qëndrojë strikt parashikimeve të legjislacionit për prokurimin publik në fuqi duke evidentuar plotësimin përmes formularit përmbledhës të vetëdeklarimit vetëm të atyre kriterëve të cilat në kuptim të nenit 82 të lex specialis dhe të nenit 26 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 në këtë fazë plotësohen përmes tij. Në këto kushte, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se për sa kohë autoriteti kontraktor ka hartuar një kriter në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi për prokurimin publik në lidhje me pretendimin e mësipërm të ankimesit, nuk mund të garantohet një mjet ankimi efektiv, pasi KPP nuk mund të shprehet mbi themelin e kërkesave, duke qenë se kriteri i hartuar nga autoriteti kontraktor në lidhje me vërtetimin e lëshuar nga shoqëria “Ujësjetllës Kanalizime Tiranë” sha, i cili konfirmon pagesën e të gjitha detyrimeve që rrjedhin nga kontratat e furnizimit me ujë, kriteri i cili sipas autoritetit kontraktor do të konsiderohet i përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit, është në kundërshtim me legjislacionin në fuqi për prokurimin publik dhe shkakton konfuzion si në përgatitjen e ofertave, ashtu dhe në vlerësimin e

tyre. Komisioni i Prokurimit Publik thekson, se kriteret e kualifikimit si dhe specifikimet teknike duhet të përcaktohen të qarta dhe të sakta nga autoriteti kontraktor si dhe në përputhje me parashikimet e legjislacionit të prokurimit publik dhe atë sektorial në fuqi, volumin dhe objektin e kontratës objekt-prokurimi, me qëllim që të kryhet një vlerësim i drejtë dhe jodiskriminues, duke mos penguar pjesëmarrjen në një procedurë prokurimi të operatorëve ekonomikë të interesuar, si dhe duke mos i dëmtuar pjesëmarrësit në këtë procedurë.

III.1.11. Bazuar në nenin 118, pika 2, gërma “b” të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar sipas të cilit: “Përpara lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik ka të drejtë: të pranojë ankesën dhe të urdhërojë autoritetin ose entin kontraktor të anulojë plotësisht ose pjesërisht një veprim ose vendim, të nxjerrë në kundërshtim me ligjin; nenit 98, pika 1, gërma “d” të këtij ligji ku thuhet shprehimisht: “Autoriteti ose enti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin sipas parashikimeve në këtë ligj”, si dhe në nenin 45, pika 1 gërma “b” të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, ku parashikohet se: “[...]Komisioni i Prokurimit Publik në kuadër të veprimtarisë së shqyrtimit të ankesave para lidhjes së kontratës procedon me: b) Vendim për pranimin e ankesës dhe urdhërimin e autoritetit/entit kontraktor, që të anulojë plotësisht ose pjesërisht një veprim ose vendim, të nxjerrë në kundërshtim me ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” [...]” Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se kriteri i përcaktuar nga autoriteti kontraktor në pikën 2.2.4 të kapacitetit ekonomik dhe financiar në kriteret e veçanta të kualifikimit të dokumenteve të tenderit, është haptazi jo në përputhje me legjislacionin për prokurimin publik dhe kjo përbën shkak për anulimin pjesërisht të dokumenteve të tenderit, me qëllim trajtimin e barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë. Në kushtet kur autoriteti kontraktor ka vlerësuar mbi një kriter i cili nuk është në përputhje me legjislacionin për prokurimin publik, KPP gjykon, se autoriteti kontraktor duhet të anulojë procedurën e prokurimit dhe në rishpalljen e saj të mbajë në konsideratë parashikimet e këtij vendimi.

III.2. Lidhur me pretendimin tjetër të paraqitur nga ankimuesi “Rej” SHPK mbi skualifikimin e tij nga procedura e prokurimit si dhe me pretendimet mbi kualifikimin e operatorit ekonomik “Silver” SHPK dhe mbi lënien të skualifikuar dhe shtimin e arsyeve të skualifikimit të operatorëve ekonomikë “Clean Fast” SHPK dhe “Pastrime Silvio” SHPK, për ekonomi në procesin e shqyrtimit administrativ ato nuk do të merren në shqyrtim pasi referuar arsyetimit më sipër të KPP-së procedura e prokurimit do të anulohet dhe ankimuesi nuk ka më interes të ligjshëm mbi pretendimet e tjera të ngritura në ankesë për veten e tij ashtu dhe për operatorët ekonomikë “Silver” SHPK, “Clean Fast” SHPK dhe “Pastrime Silvio” SHPK pjesëmarrës në procedurën e prokurimit objekt ankimi.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e

Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “Rej” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-75943-02-12-2026, me objekt: “Sherbime te pastrimit”, me fond limit 9,776,333.00, zhvilluar me datë 24.02.2026, nga autoriteti kontraktor, Tirana Parking.
 2. Autoriteti kontraktor të anulojë procedurën e mësipërme të prokurimit dhe me rihapjen e procedurës të ketë parasysh konstatimet e mësipërme të bëra nga Komisioni i Prokurimit Publik.
 3. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera dhe duke dërguar dokumentet e reja të procedurës së prokurimit të modifikuara sipas konstatimeve të mësipërme.
 4. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Rej” SHPK.
 5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
 6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiorent Zguro

